

ANALYSIS OF STATISTICAL INDICATORS FOR TOURISM DEVELOPMENT IN THE REPUBLIC OF KOSOVO

Burim Morina

Business College - Pristina, Faculty of Economics, bmorina7@hotmail.com

Abstract: The paper analyzes the statistical indicators for the development of tourism in the Republic of Kosovo. The development of tourism in Kosovo has already been completed and approximated to legislation harmonized with that of the EU and responsible institutions have been built for the administration and practical implementation of tourism, both at central and local level.

Keywords: Tourism, gross product and economic growth.

ANALIZA E INDIKATORËVE STATISTIKOR PËR ZHVILLIMIN E TURIZMIT NË REPUBLIKËN E KOSOVËS

Burim Morina

Kolegji Biznesi – Prishtinë, Fakulteti Ekonomik, bmorina7@hotmail.com

Abstrakti: Në punim shtjellohen analizat e indikatorëve statistikor për zhvillimin e turizmit në Republikën e Kosovës. Zhvillimi i turizmit në Kosovë tashmë ka arritur të kompletohet dhe të përafrohet sa i përket legjislacionit të harmonizuar me atë të BE-së dhe janë ndërtuar institucionet përgjegjëse, për administrimin dhe zbatimin praktik të turizmit, si në nivel qendror, ashtu edhe atë lokal.

Koncepte kyçe: Turizmi, bruto produkti dhe rritja ekonomike.

HYRJE

Turizmi është një nga veprimtaritë ekonomike mjaftë të rëndësishme në shoqëritë e sotme moderne. Edhe në Kosovë turizmi është degë e rëndësishme ekonomike. Industria Turistike e Kosovës ka një pjesëmarrje modeste prej 1.2% të Bruto Produktit Vendor. Sa i përket turizmit në Kosovë, mund të thuhet se, momentalisht kërkesat turistike janë të lidhura me mysafirët vendës dhe të huaj.

BRUTO PRODUKTIT VENDOR DHE RITJA EKONOMIKE NË KOSOVË

[1] Rritja ekonomike konsiderohet ndër objektivat kryesore makroekonomike të qeverisë së vendit dhe paraqet rritjen e përgjithshme të prodhimit të një ekonomie. Prandaj ajo konsiderohet si aftësi e ekonomisë së një vendi për të prodhuar më shumë mallra e shërbime për konsumatorët. Tregues i rëndësishëm në ekonominë e një vendi është Produkti i Brendshëm Bruto (Gross Domestic Product – GDP). Treguesi më i rëndësishëm ekonomik në Sistemin e Llogarive Kombëtare është Produkti i Brendshëm Bruto, i cili paraqet performancën e ekonomisë së një shteti në një periudhë të caktuar.⁷⁸ Prodhimi i Brendshëm Bruto (PBB) është vlera e tregut e të gjithë mallrave dhe shërbimeve përfundimtare të prodhuara brenda një vendi në një periudhë të dhënë kohe.⁷⁹

Kosova pas përfundimit të luftës në vitin 1999, gjendej në fazën e tranzicionit, ku proceset ekonomike kishin trende negative dhe rezultatet tregojnë se zhvillimi ekonomik përballë me shumë sfida. Si tregues makroekonomik më i përgjithshëm përmes të cilit shprehet dinamika e zhvillimit ekonomik merret Produkti i Brendshëm Bruto.

⁷⁸ Agjencia e Statistikave të Kosovës, Seria 3, Statistikat Ekonomike, Bruto Produkti Vendor 2008-2014, Prishtinë 2015, fq. 13.


⁷⁹ Mankiw, N. G. & Taylor, M. P., Economics/ Macroekonomics, Përktheu: Artan Meci, Jorgji Qirjako, UET Press 2012, fq 38.

Tabela -1. Ecuria e Bruto Produktit Vendor (BPV) në periudhën e viteve 2008-2014.-çmime aktuale.


Vitet	Bruto Produkti Vendor (milion euro)	Bruto Produkti Vendor për banorë (në euro)	BPV- Norma reale e rritjes
2008	3.882,8	2,258	4.5
2009	4.069,6	2,329	3.6
2010	4.402,0	2,480	3.3
2011	4.814,5	2,672	4.4
2012	5.058,7	2,799	2.8
2013	5.326,6	2,935	3.4
2014	5.567,5	3.084	1.2
2015	5.807.5	3.277	4.1
2016	6.070.1	3.386	4.1

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, Seria 3, Statistikat Ekonomike, Bruto Produkti Vendor 2008-2014, Prishtinë 2015, fq, 7-8.

Grafiku 1:Ecuria e Bruto Produktit Vendor (BPV) në periudhën e viteve 2008-2016.



Grafiku 2:Norma reale e rritjes së BPV-së në periudhën 2008-2016.



Nga tabela dhe grafiku, mbi ecurinë e BPV-së, në periudhën e viteve 2008-2016, shihet se vlera e BPV-së ka pasur trend rritës, duke u rritur nga 3.882,8 milionë euro sa ishte në vitin 2008, në 6.070.10 milionë euro në vitin 2016. Ndërsa, BPV për banor u rritë nga 2,258 euro sa ishte në vitin 2008, në 3.386 euro në vitin 2016. Në periudhën 2008-2016, BPV-ja e përgjithshme edhe përkundër trendit rritës, ku në vitin 2008 norma e shtimit mesatar vjetor ishte 4.5%, duke pasur rënie të lehtë në vitet në vijim, ndërsa në vitin 2016 norma reale e rritjes ishte 4.1%. Nga kjo mund të konstatojmë se: Ekonomia e Kosovës me një dinamikë të këtyllë të zhvillimit nuk ka pasur ndryshime esenciale sa i përket treguesve ekonomikë në periudhën përkatëse.

Tabela 2: Struktura e Bruto produkti vendor sipas aktiviteteve ekonomike 2008-2016

Aktivitetet ekonomike	Pjesëmarrja e BPV-së sipas aktiviteteve								
	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
Bujqësia, gjuetia , pylltaria dhe peshkim	14.8	14.1	13.6	12.8	12.2	12.0	11.9	10.3	10.5
Industria nxjerrëse	3.1	2.3	3.1	2.6	2.3	2.2	2.1	2.0	2.1
ndustria përpunuese	11.1	12.1	11.1	10.3	10.9	11.0	10.3	10.8	11.0
Furnizimi me energji elektrike, me gaz	2.1	2.3	2.5	2.6	2.5	2.7	2.8	3.3	3.5
Furnizimi me uje	0.5	0.6	0.7	0.7	0.7	1.0	0.8	0.8	0.7
Ndërtimtaria	6.6	6.6	6.4	7.5	6.7	6.6	6.0	6.8	6.5
Tregetia me shumicë dhe pakicë; riparimi i automjeteve dhe motoçikletave	11.6	12.5	12.2	11.1	12.1	12.3	12.4	12.3	12.3
Transporti dhe magazinim	3.3	3.8	3.9	3.9	3.7	4.4	3.5	3.6	3.6
Hotelet dhe restorantet	0.6	0.5	0.6	0.7	0.8	0.9	0.9	1.0	1.2
Informimi dhe komunikim	0.8	0.8	0.8	0.9	1.1	1.0	2.0	1.9	1.8
Aktivitetet financiare dhe te sigurimit	3.3	3.2	3.4	3.6	3.8	4.0	4.0	3.7	2.9
Afarizmi me pasuri të patundshme	11.0	10.2	9.5	8.7	8.6	8.9	9.0	8.6	8.0
Aktivitetet profesional, shkencore dhe teknike	1.1	1.2	1.2	1.3	1.4	1.4	1.4	1.6	1.5
Aktivitetet administrative dhe mbështetëse	0.2	0.3	0.3	0.4	0.4	0.4	0.6	0.6	0.6
Administrimi publik dhe i mbrojtjes; sigurimi i detyrueshëm social	11.1	10.3	9.9	9.9	9.8	9.3	9.0	7.8	7.7
Edukimi	2.6	2.8	2.8	3.2	3.2	3.1	3.9	4.0	4.0
Shendetësia dhe aktivitetet e punes sociale	0.9	1.1	1.3	1.4	1.4	1.4	1.8	1.9	1.9
Art, zbavitje dhe rekreacion	0.1	0.1	0.3	0.3	0.4	0.4	0.4	0.4	0.4
Sherbime tjera	0.0	0.2	0.2	0.2	0.2	0.2	0.2	0.2	0.2
Aktivitetet e ekonomive familjare si punëdhënës; Mallra dhe shërbimet e padiferencuara që prodhojnë aktivitetet e familjeve për përdorim vetanak	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
BVSH me çmime bazë	84.8	85.0	83.8	81.9	82.4	83.3	82.9	81.6	80.4

Tatimet në produkte	15.2	15.0	16.2	18.1	17.6	16.7	17.1	17.9	20.1
Subvencionet ne produkte	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Bruto Produkti Vendor	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0

Burimi: Agjencia e Statistikave e Kosovës, Seria 3: Statistikat Ekonomike, Bruto Produkti Vendor 2008 -2016, Prishtinë, 2017, fq, 6.

Në kuadër të tabelës paraqitet struktura e Bruto Produktit Vendor-BPV sipas aktiviteteve ekonomike në periudhën 2008-2016. Nga tabela shihet pjesëmarrja e aktiviteteve në BPV-në, ku gjatë periudhës referuese Hotelet dhe Restorantet në vitin 2008 kishin pjesëmarrje prej 0.6% në BPV-në, ndërsa në vitin 2016 pjesëmarrja e Hotelëve dhe Restorantëve në BPV-në ishte 1.2%.

ZHVILLIMET E TURIZMIT NË KOSOVË

Edhe në Kosovë turizmi është degë e rëndësishme ekonomike. Turizmi përfshinë aktivitetet e personave që udhëtojnë dhe qëndrojnë në vende të ndryshme nga vendi i qëndrimit të tyre të zakonshëm për një periudhë jo më të gjatë se një vit kalendarik dhe qëllimi i këtij udhëtimi është kohë e lirë, biznes e të tjera.⁸⁰ Sa i përket turizmit në Kosovë, mund të thuhet se, momentalisht kërkesat turistike janë të lidhura me mysafirët vendës dhe të huaj.

Tabela 3: Kapacitetet Hoteliere në Kosovë

[2] Regjioni	Numri i hoteleve	Numri i dhomave	Numri i shtretërve
[3] Gjakovë	10	200	288
Gjilan	9	172	221
Mitrovicë	6	119	128
Pejë	37	635	1,265
Prizren	9	244	511
Prishtinë	51	1,588	2,090
Ferizaj	15	315	357
Gjithsej	137	3,273	4,860

Burimi: Agjencia e Statistikave e Kosovës, Seria 3: Statistikat Ekonomike, Statistikat e Hotelerisë, TM3 – 2017, Prishtinë, 2017, fq, 5.

Në tremujorin e tretë të vitit 2017 (TM3 2017) në territorin e Kosovës janë 137 hotele që ushtrojnë veprimtari hoteliere, pjesa më e madhe e hoteleve gjenden në regjionin e Prishtinës, Pejës, Ferizajt, etj.

Momentalisht kërkesat turistike në Kosovë janë të lidhura me mysafirët vendës dhe të huaj. Vizitor quhet një person i cili kalon të paktën një natë në një strukturë hoteliere në vendin që ai viziton. Për qëllime të statistikave të turizmit, termi vizitor përfaqëson një person që udhëton në një vend të ndryshëm nga vendi që ai banon, për një periudhë më pak se 12 muaj.⁸¹ Ai mund të jetë vendor apo i jashtëm. Vizitor vendor është personi me vendbanim të përhershëm në Kosovë, por i cili qëndron për së paku një natë në një vend tjetër në Kosovë. Vizitor i jashtëm konsiderohet personi me vendbanim të përhershëm jashtë Kosovës, por i cili qëndron përkohësisht në Kosovë për së paku një natë.

Tabela 4: Numri i vizitorëve (vendor dhe të jashtëm) dhe netëqëndrimet e tyre, për vitet 2008 – 2016

[4] Periudha	Numri i Vizitorëve		Netë Qëndrimi	
	Vendor	Të jashtëm	Vendor	Të jashtëm
[5] 2008	19.678	24.616	22.602	46.910
2009	52.631	36.318	54.876	76.042
2010	44.662	34.382	45.123	76.394
2011	42.044	30.349	44.757	65.584
2012	49.973	48.790	52.008	90.968


⁸⁰ Agjencia e Statistikave e Kosovës, Seria 3: Statistikat Ekonomike, Statistikat e Hotelerisë, TM3–2017, Prishtinë, 2017, fq, 4.

⁸¹ Po aty, fq, 4.

2013	45.380	50.074	54.867	83.883
2014	46.477	61.313	55.274	102.066
2015	60.200	79.238	81.372	120.669
2016	45.579	83.710	62.211	131.785

Burimi: Agjencia e Statistikave e Kosovës, Seria 3: Statistikat Ekonomike, Statistikat e Hotelerisë, TM3 – 2017, Prishtinë, 2017, fq. 7.

Grafiku 3: Numri i vizitorëve vendor dhe të jashtëm për vitet 2008 – 2016



Në tabelë dhe nga grafiku është paraqitur numri vizitorëve vendor dhe të jashtëm si dhe netët e qëndrimit për vizitorët vendor dhe të jashtëm gjatë vitit 2008-2016. Në vitin 2016 numri i vizitorëve vendor është zvogëluar nga 60.200 në 45.579 vizitorë, përkatësisht për 24.29% në raport me vitin 2015, nëtëqëndrimet e vizitorëve vendor janë zvogëluar nga 81.372 në 62.211, përkatësisht për 23.55% në raport me vitin 2015. Sa i përket vizitorëve të jashtëm shihet rritje e vizitorëve të jashtëm nga 79.238 në 83.710 vizitorë, përkatësisht për 5.64% në raport me vitin 2015, kurse netëqëndrimet e vizitorëve të jashtëm janë rritur nga 120.669 në 131.785, apo për 9.21% në raport me vitin 2015. Në Kosovë lidhur me turizmin, kapaciteteve akomoduese janë tregues edhe i nivelit të zhvillueshmërisë së kësaj veprimtarie ekonomike. Kjo për faktin se kapacitetet akomoduese përfshirë hotelet, motelet, bujtinat dhe kapacitetet tjera të kësaj natyre janë në rritje e sipër në Kosovë.

Hotel- objekti që ofron fjetje, ushqim dhe shërbime të tjera për udhëtarët dhe turistët.⁸²

Motel- objekti i destinuar kryesisht për pushim dhe ndalim të personave të motorizuar, për furnizim me ushqim, pije si dhe shërbime të tjera. Objektet ndërtohen jashtë qendrave të banuara, pranë rrugëve automobilistike dhe ofrojnë këto shërbime shtesë pos vendosjes.

Bujtinë- shtëpi private që ofron shërbime të fjetjes me pagesë për turistët. Disa prej tyre ofrojnë ushqim e disa jo, varësisht prej kushteve të krijuara. Po ashtu disa janë të regjistruara në Agjencinë për Rexhistrimin e Bizneseve në Kosovë e disa janë biznese familjare;

Hostel- njësitë akomoduese që ofrojnë ushqim dhe strehim të lirë, për grupe të veçantë të njerëzve, siç janë studentët, punëtorët, apo udhëtarët. Karakteristikë e këtyre njësiteve është se këto krijohen zakonisht në brendësi të qyteteve, dhe në një dhomë vendosen disa shtretër, për grupe njerëzish;

Apartamente për vizitorë- Janë kryesisht apartamente private, të cilat njerëzit i lëshojnë me pagesë për vizitorë. Këto apartamente gjenden në kuadër të ndërtesave të banimit të njerëzve;

Bungallou- në hulumtimin tonë janë quajtur shtëpizat e drurit, të cilat e kanë apo jo edhe katin e sipërm, të ndërtuara në grupe dhe po ashtu shtëpizat e drurit që gjenden në pikat turistike siç është Brezovica, Rugova, Prevala.

⁸² Agjencia e Statistikave e Kosovës, Kapacitetet e turizmit (njësitë akomoduese) në Kosovë 2016, Prishtinë, 2017, fq. 7.

Hapësira për Kamping (parqe rekreative për automjete dhe parqe për kamp-shtëpiza)– është një vend i përdorur për kamping, për grill, që posedojnë ujë, rrymë dhe infrastrukturën tjetër të nevojshme për vizitorë.

Tabela 5: Të dhënat mbi kapacitetet akomoduese

[6] Kategoritë e njësive akomoduse	Kapacitetet		
	Njësive	Dhomave	Shtretërve
[7] Hotel	194	4,329	7,066
Motel	182	2,170	2,916
Bujtinat	9	39	79
Hostel	9	43	171
Apartamente për vizitorë	15	25	32
Bungallou	38	330	721
Hapësirë për kamping	17	-	-
Gjithsej njësi aktive	464	6,936	10,985
Njesitë jo aktive	31	-	-
Totali	495	6,936	10,985

Burimi: Agjencia e Statistikave e Kosovës, Kapacitetet e turizmit (njesitë akomoduese) në Kosovë 2016, Prishtinë, 2017, fq. 8.

Në tabelë pasqyrohen kapacitetet akomoduese në Kosovë, ku vërehet se pjesa më e madhe e kapaciteteve akomoduese përbëhet nga hotelet dhe motelet.

Tabela 6: Numri i njësive akomoduese në bazë të kategorive sipas komunave

Komuna	Hotelet	Motelet	Bujtinat	Hostelet	Apartamente për vizitor	Bungallou	Hapësirat për kampingje
Deçan	3	-	-	-	-	-	-
Dragash	2	-	-	-	-	-	-
Drenas	1	5	-	-	-	-	-
Ferizaj	4	33	4	-	-	-	-
Fushë Kosovë	13	9	-	-	-	-	-
Gjakovë	12	2	-	-	-	1	-
Gjilan	11	10	-	-	-	1	-
Graçanicë	4	8	-	-	-	1	-
Han i Elezit	-	1	-	-	-	-	-
Istog	7	6	-	-	-	-	-
Junik	1	1	-	-	-	-	-
Kaçanik	1	3	1	-	-	-	-
Kamenicë	1	1	-	-	-	-	-
Klinë	4	8	-	-	-	-	6
Lipjan	2	10	-	-	-	1	-
Malishevë	1	3	-	-	-	-	-
Mitrovicë	6	7	-	-	-	-	-
NovoBërd	-	2	-	-	-	1	-
Obiliq	4	3	-	-	-	-	-
Pejë	20	9	-	-	-	29	11
Podujevë	3	1	-	-	-	-	-
Prishtinë	42	14	2	6	15	-	-
Prizren	34	12	1	3	1	3	-
Rahovec	3	6	-	-	-	-	-

Ranillug	-	1	-	-	-	-	-
Shtërpçë	2	7				1	
Shtime	-	5	-	-	-	-	-
Skenderaj	1	2	-	-	-	-	-
Suharekë	6	4	1	-	-	-	-
Viti	2	4	-	-	-	-	-
Vushtrri	2	2	-	-	-	-	-
Zubin Potok	1	1	-	-	-	-	-
Zveçan	1	2	-	-	-	-	-

Burimi: Agjencia e Statistikave e Kosovës, Kapacitetet e turizmit (njesitëakomoduese) në Kosovë 2016, Prishtinë, 2017, fq. 13.

Në tabelë pasqyrohet numri i njësive akomoduese në bazë të kategorive sipas komunave, nga kjo shihet se pjesa më e madhe e njësive akomoduese përkatësisht hotelet dhe motelet janë të përqëndruara në qendrat më të mëdha të Kosovës përfshirë Prishtinën, Prizrenin, Pejë, Ferizaj etj.

Tabela 7: Numri i njësive akomoduese në bazë të formës ligjore sipas Komunave

Nr	Komuna	Gjithsej njësi	Biznese Individuale	Ortakëri	Shoqëri aksionare	Në pronësi të AKP-së	Të pa regjistruara
	Deçan	3	3	-	-	-	-
	Dragash	2	1	-	1	-	-
	Drenas	6	6	-	-	-	-
	Ferizaj	41	36	1	-	-	4
	Fushë Kosovë	22	19	-	3	-	-
	Gjakovë	15	15	-	-	-	-
	Gjilan	22	22	-	-	-	-
	Graçanicë	13	10	-	3	-	-
	Han i Elezit	1	1	-	-	-	-
	Istog	13	13	-	-	-	-
	Junik	2	2	-	-	-	-
	Kaçanik	5	4	-	-	-	4
	Kamenicë	2	2	-	-	-	-
	Klinë	12	12	-	-	-	-
	Lipjan	13	13	-	-	-	-
	Malishevë	4	4	-	-	-	-
	Mitrovicë	13	13	-	-	-	-
	NovoBërd	3	2	-	-	-	1
	Obiliq	7	6	-	1	-	-
	Pejë	58	43	2	-	-	13
	Podujevë	4	3	1	-	-	-
	Prishtinë	78	58	2	3	1	14
	Prizren	54	51	2	-	-	1
	Rahovec	9	9	-	-	-	-
	Ranillug	1	1	-	-	-	-
	Shtërpçë	10	10	-	-	-	-
	Shtime	5	4	-	1	-	-
	Skenderaj	3	3	-	-	-	-
	Suharekë	11	9	1	-	-	1
	Viti	6	6	-	-	-	-
	Vushtrri	4	4	-	-	-	-
	Zubin Potok	2	2	-	-	-	-
	Zveçan	3	3	-	-	-	-

Burimi: Agjencia e Statistikave e Kosovës, Kapacitetet e turizmit (njesitë akomoduese) në Kosovë 2016, Prishtinë, 2017, fq. 11.

Sa i përket formës ligjore të ndërmarrjeve 87% e tyre janë Biznese Individuale, 8% e njësive janë të paregjistruara në Agjencinë për Rexhistrimin e Bizneseve të Kosovës, ndërsa pjesa tjetër e ndërmarrjeve bëjnë pjesë në format e tjera ligjore.

PËRFUNDIMI

Rritja ekonomike konsiderohet ndër objektivat kryesore makroekonomike të qeverisë së vendit. Ecuria e rritjes reale të Bruto Produktit Vendor me normë njëshifrore konsiderohet e pamjaftueshme në uljen e normës së lartë të papunësisë dhe deficitit të lartë tregtar. Sa i përket pjesëmarrjes së aktiviteteve në BPV, në këtë kuadër pjesëmarrja e hoteleve dhe restorantëve mbetet e ulët ku në vitin 2016 ishte prej 1.2% në BPV-në. Mbetët e rëndësishme që vendimarrësit që përmes masave përkatëse në kuadër të politikave ekonomike ti kushtojnë më tepër vëmendje nxitjes së aktiviteteve në sektorin e turizmit dhe gjenerimit të vendëve të reja të punës nga ky sektor i rëndësishëm ekonomik.

LITERATURA

- [8] Mançellari, A., Hadëri, S., Kule, Dh., Qiriçi, S. (2007). Hyrje në ekonomi;
- [9] Agjencia e Statistikave të Kosovës, Seria 3, Statistikat Ekonomike, Bruto produkti Vendor 2008-2016, Prishtinë 2017;
- [10] Agjencia e Statistikave e Kosovës, Kapacitetet e turizmit (njesitë akomoduese) në Kosovë 2016, Prishtinë, 2017;
- [11] Agjencia e Statistikave e Kosovës, Seria 3: Statistikat Ekonomike, Statistikat e Hotelerisë, TM3 – 2017, Prishtinë, 2017;
- [12] Mankiw, N. G. & Taylor, M. P., Economics/ Macroekonomics, Përktheu: Artan Meci, Jorgji Qirjako, UET Press 2012;
- [13] Koka, M. (2014). Makroekonomia.